



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data <b>29.11.2023</b>	Vendi <b>KAÇANIK</b>
Nj. org.	Numri	Shtojci
01-370/01-30873	/23	



Kuvendi i Komunës  
Skupština Opština  
Municipal Assambly

## KONTRATA PËR SHËRBIME

Komuna e Kaçanikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), i përfaqësuar nga Shefket Koxha – Menaxher i prokurimit; në njëren anë dhe

"TMS MOBILE" Shpk nga Prishtinë (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar nga i autorizuar Përparim Kelmendi me Nr.personal 1175667705 ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për:

### Vendosja e sistemit GPS në veturat e administratës Komunale

me numër identifikues : **652-23-11830-2-3-6**

**KA652/23/101/236**

**Neni 1 Lënda**

#### 1.1 Lënda e kontratës do të **Vendosja e sistemit GPS në veturat e administratës Komunale**

1.2 Kontrata hynë në fuqi **30.11.2023**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **20 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës

1.4 Vendi Komuna Kaçanik

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

**Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet dë rru mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

**Neni 3 Cmimi**

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **5,988.50 €;**  
me fjalë (**Pesëmijëenëqindëtetëdhjetëetëeuro e 50/100 centë**)

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vëtmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përshtatim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

**Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro në llogarin Bankare).

**Autoriteti Kontraktues do të pagua, OE dhe atë pas pranimit të punëve nga na e menagjerit të projektit si dhe komisionit për pranim të punëve**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën débitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

**Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

**Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

**Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të punëve.

**Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzoje ndonje ose të gjitha mallrat] [t'i realizoje ndonje ose të gjitha shërbimet] [t'i kryej ndonje ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

**Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas herë të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

**Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marra e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

**Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo

nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale osje ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimit nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se huk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën komunale në Kacanik në pajtim me ligjin e Kosovës.





#### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jep Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] 2 në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Përparim Kelmendi	Emri:	Shefqet Kokha
Pozita:	Autorizuar	Pozita:	Mehaqjëri Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29.10.2023	Data:	29.10.2023
Vula:		Vula:	

Nr.	Përshkrimi furnizimeve	njësia	Sasia	Çmimi njësi (pa tvsh)	Çmimi total (pa tvsh)
Furnizimi i dhe instalimi i GPS sistemit dhe mirembajtja e aplikacionit					
1	Mirembajtja e sistemit	muaj	12	€ 40,00	€ 480,00
2	Çasja, abonimi dhe shfrytezimi i sistemit web dhe mobile	Cope	1	€ 995,00	€ 995,00
3	Furnizimi me GPS - Pajisjet	cope	20	€ 120,00	€ 2.400,00
4	Montimi i pajisjeve GPS ne automjete	cope	20	€ 10,00	€ 200,00
5	Identifikues shoferi	cope	20	€ 20,00	€ 400,00
6	I buton ( qip )	cope	150	€ 4,00	€ 600,00
				NEN TOTALI	€ 5.075,00
				TVSH	€ 913,50
<b>TOTALI I OFERTËS ME TVSH</b>					<b>€ 5.988,50</b>

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANIË	TMS MOBILE SH.P.K
ADRESA E PLOTE	Rr.Behar Begolli AL-Trade Obj.H/22-1, Prishtina e Re-Veternik, 10000 Prishtina, Kosova
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	Hajdin ÇELA
POZITA	DREJTOR
NËNSHKRIMI	
DATA	02.11.2023
VULA	